



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
P U K Ë**

ANALIZA

**E TREGUESVE TË PUNËS SË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË
SHKALLËS SË PARË PUKË.
PERIUDHA: JANAR-DHJETOR 2018**

Të nderuar pjesëmarrës!

Nëpërmjet këtij materiali, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë, ju paraqet treguesit e përgjithshëm të veprimtarisë së saj, realizuar gjatë vitit 2018, në ushtrimin e ndjekjes penale, në hetimin e çështjeve penale, përfaqësimin e akuzës para gjykatës, në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe ushtrimin e funksioneve dhe kryerjen e detyrave të tjera të parashikuara në ligj nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore.

Kjo analize është e bazuar në drejtimin dhe përparësitë tona në luftën kundër kriminalitetit dhe ka për qëllim përgjithësimin e përvojës pozitive, por njëkohësisht edhe evidentimin e mangësive dhe problemeve që kanë lindur gjatë këtij viti me synimin e vetëm përmirësimin e vazhdueshëm të treguesve dhe goditjen në kohë dhe me efikasitet të veprave kriminale në territorin e Rrethit Gjyqësor, në të cilin ajo ushtron aktivitetin e saj.

Në qendër të vëmendjes tonë gjatë vitit që analizojmë kanë qenë zbatimi me rigorozitet i Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave “***Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2018***”, zbatimi i rekomandimeve të Rezolutës së dt. 20.09.2018 “***Për vlerësimin e veprimtarisë së organit të prokurorisë për vitin 2017***” të Kuvendit të Shqipërisë të miratuar nga Prokurori i

Përgjithshëm si dhe Udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm të dala në funksion të tyre.

Në këtë kuadër, rëndësi e veçantë u është kushtuar çështjeve më problematike që shqetësojnë komunitetin e këtij rrethi që janë veprat penale **kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike**, veprat penale **kundër rendit dhe sigurisë publike** ku prioritet kanë qenë veprat penale në fushën e **narkotikëve dhe ato që lidhen me prodhimin dhe mbajtjen pa leje të armëve luftarake dhe municionit**, veprat penale në fushën e **veprimtarisë shtetërore të kryera nga nëpunësit shtetërorë**, **veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes**, **veprat penale kundër mjedisit** etj.

Në një vlerësim paraprak, duke marrë në konsideratë të dhënat që do të analizojmë në mënyrë të detajuar në vijim të këtij materiali, elementi i parë që evidentohet është se përgjatë vitit 2018, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë, ka përballuar një ngarkesë më të ulët pune krahasuar kjo me një vit më parë.

Duke zbatuar detyrimet kushtetuese si autoritet i vetëm për ushtrimin e ndjekejs penale, kemi qenë të angazhuar për të kryer një hetim sa më të plotë e të gjithanshëm. Po kështu janë bërë përpjekje për të rritur nivelin të përfaqesimit të akuzës në gjykim, për të ekzekutuar në kohë vendimet penale të gjykatave dhe për të mbikqyrur në vazhdimësi vuajtjen e dënimit të denuarve, si dhe për të bashkërenduar punën me të gjithë aktoret e tjera të luftës kundër kriminalitetit përfshirë këtu Policinë e Shtetit dhe organet e tjera ligjzbatuese. Rëndësi i është kushtuar edhe përmbushjes së detyrimeve lidhur me marrdheniet juridiksionale me autoritetet e huaja në fushën e zbatimit të leterporosive, ekstradimeve, njohjes së vendimeve penale të huaja etj.

Krahas kësaj, në përputhje me detyrimet e parashikuara shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligjin procedural penal jemi përpjekur që në veprimtarinë tonë të respektojmë të gjitha kërkesat e një procesi të rregullt ligjor si ndaj personave të dyshuar si autorë të veprave penale duke u garantuar të gjitha të drejtat që iu njeh ligji, si dhe ndaj viktimave të këtyre veprave duke u dhënë prioritet shtresave më vulnerabel të shoqërisë si të miturve, grave apo personave që nuk kanë mundësi për tu mbrojtur.

Për veprat penale të rënda me ndjeshmëri të madhe në opinionin publik e shoqëror kemi bërë përpjekje serioze që hetimet t'i përfundojmë shpejt e me cilësi, duke zbatuar një politikë ndëshkimi në përputhje me rëndësinë e faktit

dhe efektet për parandalimin e tyre me qëllimin e vetëm për të garantuar një jete të sigurtë dhe me sa më pak probleme për komunitetin.

Gjithashtu një rëndësi të veçantë i është kushtuar implementimit në praktike të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm si dhe ato të ndryshimeve ligjore në kuadrin e reformës në drejtësi.

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Në vitin 2018, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë ka hyrë me **42 procedime** penale të mbartura në hetim nga viti 2017, me 8 persona në hetim, me 20 të pandehur, ndër të cilët 1 me masë sigurimi “arrest në burg”.

Duke parë dhe analizuar gjendjen e kriminalitetit në tërësi, rezultoi se gjatë vitit 2018, situata në rrethin e Pukës, në aspektin penal, ka patur një tendencë në drejtim të uljes së numrit të çështjeve, ku për këtë vit janë rregjistruar në tërësi 166 **kallezime** penale të reja. Në raport me vitin 2017 ku janë rregjistruar 207 kallezime, pra me 41 kallezime më pak këtë vit.

Nga kallezimet e rregjistruara, **1** kallezimi është filluar kryesisht, **13** janë referuar nga nënpunësit publikë, **13** kallezime janë referuar nga shtetasit, **si dhe 139** kallezime janë referuar nga policia e shtetit, ndër këto **29** janë me vendngjarje. Për tu theksuar është fakti që mungojnë referimet dhe kallezimet nga personeli mjekësor, nga policia financiare, nga policia pyjore, etj. Kjo ka ndodhur edhe për shkak të riorganizimit të Drejtorive Rajonale.

Gjatë vitit 2018, në lidhje me kallezimet penale të rregjistruara është vendosur për mosfillimin e hetimeve apo të procedimeve, **për 33 kallezime**, nga të cilat: **5** kallezime për nenin 84 të K.Penal për shkak se nuk ekziston fakti penal, **1** kallzim për nenin 88, **1** kallezime për nenin 99, **3** kallzim për nenin 150, **3** kallezime për nenin 151; **6** kallezime për nenin 205, **3** kallezime për nenin 206 a/1, **1** kallezim për nenin 248, **1** kallezim për nenin 278/1, **1** kallezim për 290/1, të Kodit Penal etj.

Vlen për tu theksuar fakti se pjesa kryesore e vendimeve të mosfillimit lidhet me nenet 84, 150, 150/1, 205, 206 a/1 të K.Penal. Këtu rezultoi se kallezimet e bera për shkatërrim prone shkatërrim prone me zjarr kemi të bëjmë me vlera të ulëta të dëmit të shkaktuar, apo kemi të bëjmë me ngjarje aksidentale dhe jo me vepra penale. Gjatë periudhës 01 Janar deri me 31 Dhjetor të vitit 2018, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë, ka regjistruar **135 procedime penale të**

reja, me 9 persona nen hetim, me 32 te pandehur, nder te cilet 12 të arrestuar.

-3-

Jane **rifilluar** hetimet per **20 procedime** penale nga keto te 20 pezulluara.

Kane ardhur me **transferim 3 procedime** penale, me 1 person nen hetim.

Gjate vitit 2018 kane qene ne hetim gjithesej **200 procedime penale** me 18 persona nen hetim, me 52 të pandehur, nder te cilet 13 te arrestuar.

Gjatë periudhës 1-vjeçare për vitin 2018, jane përfunduar procedimet penale si me poshte;

Jane derguar kerkesat per **pushim 67 procedime** penale. Nga keto 67 kerkesat jane pranuar kerkesat ne Gjykatën e Shkalles se Pare, nder keto per 9 raste vendimet nuk kane marre forme te prere per shkak se palet e interesuara kane ushtruar ankim ne Gjykatën e Apelit Shkoder, ndersa me vendim te Prokurorit kemi 1 rast te pushimit per vepren penale 89 te K.Penal. Procedimet penale te pushuara rezulton se 42 procedime penale jane pushuar per mungese fakti, 4 procedime penale jane pushuar per mungese provash, ndersa 22 procedime penale jane pushuar për shkaqe te tjera. *Nga keto procedime penale jane pushuar 20 **procedime te pezulluara te viteve te kaluara**, dhe te rifillura per efekt të parashkrimit te ndjekjes penale.*

Gjatë periudhes ne fjalë, për moszbulim të autorit të vepres penale, **jane pezulluar hetimet për 45 procedime** penale. Nga keto 25 procedime per nenin 134/1,2 dhe 3 procedime per nenin 150 të K.Penal, 2 procedime neni 283/1,3 procedime 284/1 , si dhe per vepra te tjera penale, nga ku per hetimin e ketyre procedimeve penale jane hasur probleme ne hetimin e veprave penale te vjedhjes, si dhe ne hetimin e vepres penale te kultivimit te bimeve narkotike per shkak te veshtiresive te terrenit malor dhe te perhapur te rrethit te Pukes.

Jane **transferuar gjithesej 4 procedime penale**.

Nga këto procedime 2 jane per kompetencë lendore ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Shkodër, ne seksionin per të mitur ndersa 2 raste te tjera ne per kopetence tokesore ne Prokurorite kopetente.

Gjatë vitit 2018, janë **dërguar për gjykim 34 procedime penale** me 52 të pandehur, nder te cilet 10 me mase sigurimi “arrest ne burg”. *Rezulton se numeri i procedimeve penale te derguara ne gjykim ne krahasim me vitin 2017 është me i ulet, ku ne vitin 2017 jane derguar per gjykim 55 procedime penale me 60 te pandehur, nder te cilet 20 me*

-4-

mase sigurimi “arrest ne burg” kjo per arsyen se ne vitin 2018 ka patur numer procedimesh penale me te ulet.

Për gjithë periudhen 1-vjeçare ne fjale, jane perfunduar gjithsej **147 procedime penale** me 52 persona te pandehur, nder te cilet 10 me mase sigurimi “arrest ne burg”.

Kanë mbetur në hetim te mbartura **49 procedime penale** me 17 persona nen hetim, nder keta 2 person me mase sigurimi “arrest ne burg”.

Nga analizimi sipas kreteve të K.Penal te treguesve te mësipërm rezulton si më poshtë;

VEPRA PENALE KUNDËR PERSONIT (JETES, SHENDETIT DHE FAMILJES).

Jane mbartur nga viti i kaluar **5 procedime penale** ne hetim per veprat penale te parashikuara nga nenet 99 per 3 procedime penale, 130/a-1 2 procedim penal.

Jane regjistruar për vitin 2018 gjithsej, **24 procedime penale** me 10 te pandehur, ndër të cilet 8 persona me mase sigurimi “arrest ne burg”.

Për keto grup-veprash penale gjate vitit 2018 jane hetuar gjithsej **29 procedime** penale me 4 persona nen hetim, 10 te pandehur, nder te cilet 8 me mase sigurimi “arrest ne burg”.

Jane derguar per pushim 10 kerkesa, **per 10 procedime penale**, pranuar nga Gjykata 10 kerkesat, nga te cilet jane pushuar per mungese fakti 8 procedime, dhe 2 procedime jane pushuar per mungese provash, per veprat penale te parashikuara nga nenet 99 dhe 130/a-1/1 te Kodit Penal.

Jane **transferuar 2 procedime** penale, per veprat penale te parashikuara nga nenet 121/a-1 dhe 130/a-1 të K. Penal.

Jane derguar për **gjykim 9 procedime** penale me 10 te pandehur, nder te cilet 6 me mase sigurimi “arrest ne burg”, nga këto:

-5-

-2 procedim penale me 3 te pandehur 1 me arrest ne burg” per nenin 89 te K.Penal;

- 5 procedime penale me 5 te pandehur, 3 te arrestuar per nenin 130/a-1 te K.Penal;

- 1 procedime penale me 1 te pandehur,me 1 te arrestuar per nenin 130/a-3 te K.Penal;

- 1 procedime penale me 1 te pandehur,me 1 te arrestuar per nenin 130/a-4 te K.Penal;

Gjithesej për periudhen ne fjalë, per keto vepra penale jane **perfunduar 22 procedime penale** me 10 persona te pandehur, nder te cilet 6 me mase sigurimi “arrest ne burg”. Ka mbetur ne hetim 7 procedime penale me 4 persona nen hetim, me 2 persona me arrest ne burg per veprat penale te parashikuara nga nenet 79/dh-22, 84,89 te K.Penal etj.

Per vitin 2018 është pezulluar 1 procedim penal per vepren penale te parashikuar nga neni 99 te K.Penal.

Duke krahasuar treguesit statistikore per keto vepra penale me vitin e kaluar, rezulton se veprat penale kundër personit kane patur te njejtet tregues perafersisht, duke perfshire edhe veprat penale per krime kundër jetes, vrasje, apo edhe veprat me te lehta si, plagosje, kanosje, etj.

VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË DHE EKONOMISË

Jane mbartur nga viti i kaluar **20 procedime** penale me 15 persona nen hetim.

Gjate vitit 2018 jane **regjistruar 63 procedime** penale, me 9 te pandehur ,nder te cilet 1 persona me mase sigurimi ”arrest ne burg”.

Jane **rifilluar 19 procedime penale nga pezullimet per keto grup veprash penale.**

Gjithesej janë **hetuar 102 procedime** penale me 6 persona nen hetim, 24 te pandehur nga te cilet 1 mase sigurimi “arrest ne burg”.

-6-

Ka **ardhur me transferim 2 procedim** penale per keto grup veprash penale. Për këto vepra penale, gjithesej janë derguar kerkesat per **pushim 43 procedime** penale. Nga këto, pranuar nga Gjykata te gjitha kerkesat. Nga keto

-6-

24 procedime penale janë pushuar per mungese fakti (nder keto 10 procedime per nenin 135 te K.Penal), 1 procedim penal pushuar per munges provash dhe 18 procedime penale për shkaqe te tjera. *Theksojme se pothuajse të gjitha procedimet penale te pushuara per shkaqe te tjera, janë procedimet penale te cilat janë pushuar per shkak te parashkimit te ndjekjes penale, per veprat penale kryesisht te parashikuara nga nenet 134/1,2,150, 151, të K.Penal.*

Për këto grup veprash penale, janë **pezulluar** hetimet per **31 procedime** penale per moszbulim te autorit te vepres penale ku pjesa me e madhe e ketyre procedimeve te pezulluara janë per veprat penale te parashikuara nga nenet 134,1,2 (25 *procedime*), 150 (3 *procedime*), 143/1 (1 *procedim*), 161 (1 *procedim*) dhe 189/1 (1 *procedim*) të K.Penal.

Janë **transferuar** per kompetence lëndore dhe teritoriale në Prokurorite e tjera, 1 procedime penale, per vepren penale te parashikuara nga neni 186/1 i K.Penal;

Për këtë seksion veprash penale, janë derguar për **gjykim 9 procedime** penale me 24 te pandehur, ndër të cilet 1 me mase sigurimi “arrest ne burg”,

-1 procedime per nenin 134/2 me 1 te pandehur.

-2 procedime per nenin 137/1 me 2 te pandehur.

-1 procedime per neni 139 me 2 te pandehur me mase sigurimi 1 “arrest ne burg”.

-2 procedim per nenin 143/1 me 16 te pandehur.

-1 procedime per nenin 145 me 1 te pandehur.

-1 procedime per nenin 150 me 1 te pandehur

-1 Procedim penal per neni 186/1 me 1 te pandehur

Për periudhen ne fjale janë përfunduar gjithesej **84 procedime** penale me 24 te pandehur nga te cilet 1 të arrestuar.

Jane mbartur në hetim per vitin ne vazhdim **24 procedime** penale me 1 persona nen hetim.

Nga treguesit e mesiperm krahasuar me vitin e kaluar rezulton se ka tendence rritje te procedimeve penale te regjistruara per veprat penale kundër pasurise dhe ekonomise.

VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT.

Nga viti i kaluar nuk ka pasur procedime penal te mbartura per kete grup veprash penale.

-7-

Gjate vitit 2018, jane rregjistruar **2 procedime** penal, -1 procedime penale per nenin 206 me 1 te pandehur dhe 1 procedim penal per nenin 206/a-1 i K.Penal.

Nuk ka pasur asnje raste rifillim te hetimeve nga pezullimet per kete grup veprash penale.

Gjithashtu nga viti i kaluar nuk ka pasur asnje kerkese per pushim te procedimeve penale per kete grup veprash penale.

Është pezulluar 1 procedim penal per maszbulim autori per vepren penale te parashikuar nga neni 206/a-1 i K.Penal.

Është derguar per gjykim 1 procedim penal me 1 te pandehur per nenin 206 te K. Penal

VEPRAT PENALE KUNDËR AUTORITETIT TE SHTETIT.

Janë mbartur nga viti i kaluar 14 **procedime** penale me 2 persona nen hetim, me 4 persona te pandehur, nder te cilet 1 i arrestuar.

Gjate vitit 2018, jane **regjistruar 42 procedime** penale me 5 persona nen hetim, 9 te pandehur, nder te cilet 3 të arrestuar.

Është rifilluar 1 procedime penale nga pezullimet per nenin 284/1 te K.Penal.

Nga këto vepra penale per vitin 2018 jane hetuar gjithesej **58 procedime** penale me 7 persona nen hetim, 13 te pandehur, nder te cilet 4 të arrestuar.

Gjatë periudhes ne fjale, jane derguar kerkesat per pushim te hetimeve **per 14 procedime** penale. Nga këto, 9 procedime penale per mungese fakti, 1 procedim penal per munges provash dhe 4 procedime per shkaqe te tjera. Nga

këto, 1 procedim penal per nenin 89 te K.penal,1 procedim për nenin 238, 6 procedime per nenin 248, 1 procedim per nenin 275, 1 procedime per nenin 277, 1 procedim per nenin 278/3, 1 procedim penal per nenin 283/1 te K.Penal,1 procedim per nenin 290/3, 1 procedim per nenin 291 te K.penal ,

Jane pezulluar hetimet per mosnjohje te autoresise se veprave penale per

-12 procedime penale.

- 2 procedime penale per nenin 275 te K.Penal
- 2 procedime penale per nenin 278/1 te K.Penal

-8-

- 1 procedime penale per nenin 278/2 te K.Penal
- 1 procedime penale per nenin 278/3 te K.Penal
- 2 procedime penale per nenin 283/1 te K.Penal
- 3 procedime penale per nenin 284/1 te K.Penal
- 1 procedime penale per nenin 284/2 te K.Penal

Është transferuar ne nje Prokurori tjetër **1 procedim** penal.

Jane derguar per **gjykim 12 procedime** penale me 13 te pandehur nga të cilët 3 me mase sigurimi “arrest në burg”.

Nga të dhenat statistikore rezulton se jane perfunduar gjithesej **39 procedime penale** me 13 te pandehur ndër të cilet 4 me mase sigurimi “arrest ne burg”.

Kane mbetur **ne hetim 19 procedime** penale me 6 persona nen hetim, Nje pjese e madhe e këtyre procedimeve penale jane regjistruar ne periudhen e fundvitit dhe jane per veprat penale te parashikuara nga nenet 242, 248, 283/1,2, etj, te K.Penal, per te cilen kane ndikuar vonesat ne berjen dhe administrimin e akteve te ekspertimeve kimike.

Nga treguesit statistikor te mesiperme krahasuar me vitin e kaluar rezulton se ka me pak procedimeve penale te rregjistruara per keto vepra penale.

VEPRAT PENALE KUNDËR DREJTESISË.

Jane te mbartura nga viti i kaluar 2 procedime penal, per vepren penale te parashikuar nga nenin 305 te K.Penal.

Gjate vitit 2018, është rregjistruar 4 procedime penale, me 3 te pandehur, per nenet 301 e 311,312/a e 320 te K.Penal.

Ardhur me transferim nuk ka asnje procedim penal per keto grup veprash penale.

Nga këto vepra penale per vitin 2018, jane hetuar gjithesej 6 procedime penale me 4 te pandehur.

Gjate periudhes ne fjale nuk kemi asnje kerkese per pushim te procedimeve penal per keto grup veprash penale .

Gjate periudhes ne fjale nuk ka pasur çështje te pezulluara per kete grup veprash penale dhe gjithashtu nuk ka pasur procedime te transferuara.

-9-

Jane dërguar per gjykim 3 procedime penale me 4 te pandehur, per nenent 1 procedim penal per nenin 301 te K.Penal me 2 te pandehur,dhe 2 procedime penale per nenin 305 te K.Penal me 2 te pandehur.

Jane mbartur ne hetim per kete seksion veprash penale 3 procedime penale,2 per nenin 305 te K.Penal dhe 1 procedim penal per nenin 301 te K.Penal.Gjithsej 4 persona nen hetimm.

Nga të dhenat statistikore, rezulton se krahasuar me vitin e kaluar ka pasur rritje te procedimeve penale te rregjistruara per keto vepra penale.

VEPRAT PENALE QE LIDHEN ME ZGJEDHJET

Është mbartur nga viti i kaluar 1 procedim penal per vepren penale te parashikuar nga neni 325 i K.Penal, procedim penal i cili është derguar kerkesa per pushim per mungese fakti ,kerkese e cila është pranuar nga Gjykata e Shkalles se Pare Puke,dhe pas ankimimit pales se te interesuar është lene ne fuqi kerkesa per pushim.

- TREGUESIT STATISTIKOR TË PËRFAQESIMIT TË AKUZES NE GJYKATË NGA PROKURORET E PROKURORISË PUKË, PËR PERIUDHËN 01 JANAR - 31 DHJETOR TE VITIT 2018, JANE SI ME POSHTE :

Nga çështjet e perfunduara jane derguar në gjykim 34 procedime penale me 52 te pandehur, nga te cilet 10 te arrestuar. Ku krahasuar me nje

vit me pare rezulton se ka renjie te numer të çështjeve te derguara ne gjykim, (55

procedime ne vitin 2017), per shkak te numerit me te ulet te rregjistrimit te procedimeve penale per vitin 2018.

Rezulton se jane mbartur ne **gjykim 36 çështje penale**, me 54 te pandehur nder te cilet 11 me mase sigurimi “arrest ne burg”. Gjithsej kane qene ne gjykim 91 procedime, me 114 te pandehur, nder te cilet 31 me mase sigurimi “arrest ne burg”.

Gjithsej jane **gjykuar** gjatë këtij viti 43 çështje, me 53 te pandehur nga te cilet 16 me mase sigurimi arrest ne burg.

Gjatë vitit 2018, jane gjykuar me proceduren e gjykimit te zakonshem **10 çështje**. - Me gjykim te **shkurtuar 26 çështje** dhe **7 çështje është gjykuar me proceduren e gjykimit te drejtperdrejte**. *Numeri i ulet i çështjeve te*

-10-

gjykuara me proceduren e gjykimit te drejtperdrejte është per shkak te veshtiresive ne mbledhjen e provave.

Nga treguesit statistikor rezulton se nga ana e prokurorise është kërkuar denimi me **gjobë ne 6 raste**, është kerkuar denim **minimal ne 1 rast**, është kerkuar denim **mesatar 29 raste** dhe ne **2 raste** është kerkuar denim ne maksimum. Ështe kerkuar pezullimi i denimit bazuar ne nenin 59 te K.Penal në **14 raste**. Gjithashtu per 2 raste është kerkuar pushimi i çështjes (kryesisht per heqje dore).

Nga ana e Gjykatës janë dhene dënime me **gjobe në 3 raste**, është dhene denim ne **minimum në 3 raste**, është dhene denim **mesatar në 14 raste** dhe denim **maksimal per 1 rast**. Ndërsa ne **22 raste** është aplikuar pezullimi i dënimit sipas nenit 59 te K.Penal. Në **2 raste** është vendosur **pushimi i çështjes** dhe në 11 raste është dhënë pafajësi.

Gjithsej ka përfunduar gjykimi per 43 procedime penale me 53 te pandehur nga te cilet 16 te arrestuar. Vazhdon gjykimi per 30 procedime me 40 te pandehur nga te cilet 6 te arrestuar.

Në lidhje me kerkesat tona per llojin dhe masen e denimeve, dënimet me gjobe jane kerkuar ne ato raste kur është vleresuar rrezikshmeria e vogel e veprave penale dhe e autoreve te tyre si dhe ne ato raste kur dispozita ka parashikuar vetem kete lloj denimi. Konkretisht, ky lloj denimi është kerkuar

nga ana jone per veprat penale 242, 274 , 277 etj. Denimi me burgim ne minimum si dhe denim me kusht është kerkuar ne nje numer te veprave penale me rrezikshmeri te vogel ose per shkak te personalitetit te pandehurit si per nenet

84, 89, 277 etj. Gjithashtu jane marre parasysh rrethanat lehtesuese, kohen relativisht te gjate te kryerjes se vepres penale, moshen e te denuarit, pendimin e shfaqur si dhe vleren e vogel te demit te shkaktuar nga i pandehuri, etj.

Ndërsa nga ana jone është ndjekur nje politike e ashper denimi ndaj te pandehurve qe kane kryer vepra penale kundër pasurise si ato te vjedhjes, te dhunes ne familje, etj. Nje qendrim relativisht i ashper është mbajtur per veprat penale qe kane cenuar rendin dhe sigurine publike si, ato te mbajtjes pa leje te armeve luftarake sidomos ne ato raste kur armet jane mbajtur ne vende publike apo kur i pandehuri ka kanosur me arme apo ka kryer veper tjeter. Po ashtu, nje qendrim i ashper ne kerkesat tona per llojin dhe masen e denimit është mbajtur edhe ne veprat penale te prodhimit dhe shitjes se narkotikeve. Kerkesat

-11-

tona per denime me burgim drejt maksimumit te saksionit kryesisht jane bere per veprat penale te renda, 284/2 të K.Penal, etj.

Janë apelur vendimet e Gjykatës, nga ana e Prokurorise per 17 çështje, për masa denimi, për pafajesi, si dhe apeline kundërshtuese ndaj ankimeve të pandehureve dhe pales mbrojtese të të pandehurit. Nga këto, nje pjese e konsiderueshme jane pranuar nga Gjykata e Apelit ose është mbështetur ankimi i prokurorit per masat e denimit, ndersa ne rastet e tjera çështjet jane ne gjykim.

Në lidhje me pafajsitë rezulton si me poshte:

- 1 procedim penal per nenin 137/1 te K.Penal, Gjykata e Pukes ka dhene pafajsi per 4 persona, ku per te cilin është ushtruar ankim ne Gjykatën e Apelit Shkodër dhe nuk jane marre akoma vendimet e formes se prere.

- 1 procedim penal per nenin 118 të K.Penal, Gjykata e Pukes ka dhene pafajsi per 1 person, ku per te cilin është ushtruar ankim ne Gjykatën e Apelit Shkoder dhe nuk jane marre akoma vendimet e formes se prere.
 - 3 procedime penale per nenin 248 të K.Penal, Gjykata e Pukes ka dhene pafajsi per 5 persona,ku per te cilet është ushtruar ankim ne Gjykatën e Apelit Shkoder dhe nuk është marre akoma nje vendim i formes se prere.
 - 1 procedim penale per nenin 277 te K.Penal, Gjykata e Pukes ka dhene pafajsi per nje person, ku per te cilin është ushtruar ankim ne Gjykatene Apelit Shkoder dhe nuk është marre akoma nje vendim i formes se prere.
- **Është ankimuar ne Gjykate**, 1 vendime per mosfillimin e procedimit penal dhe per kete Gjykata ka vendosur shfuqizimin e vendimit te mosfillimit, ku ndaj ketij vendimi është ushtruar ankim dhe Gjykata e Apelit Shkoder por akoma nuk e ka marre ne shqyrtim.*

EVIDENCAT STATISTIKORE TË ARRESTIMEVE, NDALIMEVE DHE MASAVE TE SIGURIMIT TË KERKUARA DHE VENDOSURA NDAJ TE PANDEHUREVE PER PERIUDHEN 01 JANAR-31 DHJETOR 2018.

Gjate vitit 2018, jane arrestuar në flagrancë nga policia gjyqesore 16 te pandehur dhe jane ndaluar me inisiative 3 te pandehur. Nuk ka pasur raste nga

-12-

Prokuroria që të kete urdheruar lirimin e menjëhershëm te të arrestuarve apo ndaluarve. Në total jane arrestuar dhe ndaluar 19 të pandehur.

Jane kërkuar vleftësimet si të ligjshme, për 19 arrestime dhe ndalime te bera nga policia gjyqesore. Në 19 raste gjykata ka vendosur vleftesimin si ligjshem te arrestimeve dhe ndalimeve.

Është kerkuar nga Prokuroria per 18 te arrestuar masa e sigurimit “arrest ne burg”, per 1 te arrestuar është kerkuar masa e sigurimit “detyrim per tu paraqitur ne policise gjyqesore”. Gjithesej jane kerkuar masa shtrenguese per 19 te arrestruar apo te ndaluar.

Gjykata ne lidhje me kerkesat e Prokurorise, ka vendosur per 13 te arrestuar masen e sigurimit “arrest ne burg”, per 6 te arrestuar është vendosur masa “Detyrim per paraqitje”.

Jane dhene gjithesej 19 masa shtrenguese. Jane apeluar nga Prokuroria masat per 6 te arrestuar, ku është kerkuar arrest ne burg dhe nga gjykata Apelit është lene ne fuqi vendimi i gjykates. Ndërsa nga ana e te arrestuarve është bërë ankim ne 2 raste. Gjithesej jane apeluar 8 masa sigurimi.

Duhet theksuar se Gjykata ka vendosur ne raport me kerkesat e Prokuroreve per masat e sigurimit te kerkuar persa i perket veprave penale te renda si ato kundër personit, vjedhjes se pasurise, per veprat penale qe kane cenuar rendin dhe qetesine publike, mbajtjes pa leje te armeve luftarake, prodhimit dhe shitjes se narkotikeve, etj.

Gjate vitit 2018 nuk kemi pasur kerkesa per masa te sigurimit per veprat penale te korrupsionit, pastrimit te parave dhe vepra ne fushen e tatimeve.

Gjithashtu nga ana e prokurorise nuk është kerkuar caktimi i masave te sigurimit Garanci pasurore dhe Ndalimi i qendrimit ne nje vend te caktuar te parashikuara nga nenet 235, 236 të K.Pr.Penale, pasi nuk jane evidentuar plotesimi i kriterëve per keto masa dhe gjithashtu, ato nuk jane aplikuar ne asnje rast nga gjykata.

- TREGUESIT STATISTIKORE TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE GJATE PERIUDHES NJE VJEÇARE PER VITIN 2018.

Në lidhje me ekzekutimet jane nxjerre urdherat e ekzekutimit brenda afatit ligjor për të gjitha vendimet e formes se prere te ardhura ne Prokurori.

-13-

Jane mbartur nga viti 2017 si te paekzekutuara **vendimet penale per 59 te denuar**, 2 te denuar me burgim të perjetshem, 37 te denuar me burgim, 3 i denuar me gjobe dhe 17 te denuar me denime alternative.

Gjate vitit 2018, jane nxjerre nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Pukë, urdherat e ekzekutimit te vendimeve penale per 77 të dënuar, 24 te denuar me burgim, 12 te denuar me gjobë. Gjithashtu jane nxjerre edhe 41 urdhera per denime alternative, te cilet jane vene te gjithe ne ekzekutim.

Gjate vitit 2018 rezulton te jene ekzekutuar plotesisht vendimet penale per 6 te denuar me burgim, si dhe 5 per te denuarit me gjobe dhe 7 te denuarit me denime alternative.

Kane mbetur te paekzekutuara vendimet penale per 18 te denuar me burgim, 7 per te denuar me gjobe dhe 34 te denuar me denime alternative.

Për sa i perket ekzekutimit të vendimeve penale për të denuarit me burgim në mungesë dhe me gjohje theksojmë se ka përmirësime në krahasim me vitet e mëparshme.

Nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pukë rezulton se për vitin 2018 nuk ka patur asnjë kerkese për ekzekutimin e leterporosive për jashtë shteti, gjithashtu nuk ka pasur kërkesa për ekzekutim leterporosie të ardhura nga jashtë shteti.

Duke i marrë në përgjithësi, treguesit statistikore të ndjekjes penale për vitin 2018, rezulton se janë regjistruar një numër procedimesh më i vogël se në vitin 2017. Numrin më të madh të procedimeve penale, e zënë veprat penale kundër pasurisë (vjedhje të ndryshme), shpërdorim detyrës, e dhe pas tyre janë veprat penale kundër autoritetit të shtetit. Në përgjithësi vërehet se ka një tendencë të përgjithshme në uljen e numrit të veprave penale, në seksionet e ndryshme të veprave penale, në krahasim me vitin e kaluar.

Për sa i perket treguesve statistikorë në hetimet paraprake dhe në gjykim vlen të theksojmë se ka një rritje të cilësisë dhe shpejtesisë së punës në hetimin e çështjeve penale. ,nga ku del se për vitin 2018 nuk ka pasur zgjatje të afatëve të hetimeve dhe nuk ka pasur vendime për pavlefshmeri të akteve nga ana e gjykatës.

Në Prokurorinë Pukë gjatë vitit 2018 ka patur mosplotsim organikë të prokurorëve pasi në organikë kemi përveç drejtuesi edhe dy prokurorë të tjerë. Pas largimit me datë 08.01.2018 të prokurorit Ardian Nezha, është caktuar

-14-

prokuror i perkohëshme Prokurori Agron Gjana i cili është paraqitur në punë vetëm një ditë pasi kishte marrë raport mjekësorë deri me datë 17.04.2018. Me datë 18.04.2018 është caktuar prokuror i perkohëshme Prokurori Florian Bonjaku i cili është rikthyer në pozicionin e mëparshëm me datë 17.09.2018 në prokurorinë Krujë. Me datë 20.09.2018 është caktuar prokurorë e perkohëshme Prokurorja Sonila Muhametaj e cila është paraqitur në punë vetëm një ditë pasi kishte marrë raport mjekësorë dhe me datë 02.11.2018 është transferuar në prokurorinë Tiranë. Me datë 02.11.2018 është caktuar prokurorë e perkohëshme Prokurorja Esmeralda Ndoci, ku ka punuar në këtë prokurori për rreth një muaj dhe më pas është transferuar në prokurorinë Elbasan.

Ku vlen te theksohet se pothuajse pergjata te gjith vitit 2018 ne kete prokurori ka ushtruar funksionin e prokurorit vetem drejtuesja e saj.

Roli i Prokuroreve ne raport me policine gjyqesore ka qene aktiv dhe efektiv gjate hetimeve paraprake. Një vemendje e veçante është kushtuar edhe ne kryerjen e veprimeve te para hetimore ne vendngjarje, veçanerisht ne ato te veprave penale kundër personit, shkeljes se rregullave te qarkullimit rrugor, apo ne vepra te tjera te renda, ku pjesemarraja e prokurorit ka qene efektive, ne drejtimin e hetimeve dhe orientimin e oficerëve ne kryerjen e veprimeve te duhura hetimore.

- PËR SA I PËRKET VOLUMIT TË PUNES SË PROKURORËVE DHE OFICERËVE TREGUESIT JANE SI MË POSHTË :

Nga Drejtuesi i Prokurorisë Elidjana Kasa, jane marre ne hetim gjithesej 113 materiale hetimore per vitin 2018 dhe mbartur 4 materile hetimore nga viti 2017, nga keto materiale është vendosur mosfillimi për 25 kallezime penale dhe jane hetuar 121 procedime penale (*te filluara dhe veçime 97 Procedime penale + 24 procedime penale te mbartuara nga viti 2017*) si dhe është vendos rifillimi i hetimeve per 20 procedime penale te pezulluara ne vitet e meparshme. Jane pushuar 51 procedime penale nga te cilit 20 procedime jane pushuar per shkak te parashkrimit, jane pezulluar 39 procedime penale, jane transferuar 4 procedime penale, jane derguar ne gjyq 32 procedime penale, ka mbrojtur akuzen ne gjykate per 44 procedime penale si dhe çështjet direkte. Jane mbartur ne hetim 15 procedime penale. Theksojme se nje pjese e madhe

-15-

e procedimeve penale te pezulluara jane per veprat penale te parashikuara nga neni 134 e 284 i K.Penal.

Nga prokurori Flarjan Bonjaku, jane marre ne hetim gjithesej 53 materiale hetimore per vitin 2018, nga keto materiale është vendosur mosfillimi për 8 kallezime penale, është transferuar 1 kallezim penal dhe jane regjistruar 44 procedime penale procedime penale, ka patur ne hetim edhe procedime penale te tjera qe me pare i kane patur prokuroret e tjere. Jane pushuar 14 procedime penale, jane pezulluar 2 procedime penale, jane derguar ne gjyq 3 procedime penale, ka mbrojtur akuzen ne gjykate per 2 procedime penale.

Nga prokurorja Esmeralda Ndoci, janë marre për hetim gjithsej 41 procedime penale (*Nga keto 10 të mbartura nga viti 2017 + 31 të filluara në vitin 2018*). Janë pushuar 2 procedime penale, janë përfunduar 4 procedime penale, është dërguar në gjyq 1 procedime penale.

Nga ana e prokurorëve janë përfaqësuar edhe një numër i konsiderueshëm i çështjeve penale të paraqitura në gjykate bazuar në nenin 59 të K.Pr.Penale dhe gjithashtu edhe në çështje civile, në të cilat parashikohet nga ligji pjesëmarrja e prokurorit (Heqje apo kufizim i zotesisë për të vepruar, etj).

Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pukë ka patur në organik dy oficer të policisë gjyqësore, oficeret Hasan Hasani e Ludovik Ndokaj, ky i fundit ka punuar në Prokurorinë Puke deri me datë 30.04.2018, pasi na është shkurtuar organika për 1 oficer të policisë gjyqësore dhe se është transferuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, oficeret e seksionit të Prokurorisë ka pasur në hetim të gjitha çështjet e filluara në prokurori në bazë të kallezimeve të shtetasve apo institucioneve publike, por për shkak të ndryshimeve të shpeshta të oficerëve të policisë gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Puke janë ngarkuar edhe me hetimin e çështjeve të ardhura nga Komisarati i Policisë.

Nga oficeri Hasan Hasani janë marre 23 procedime të mbartura nga viti 2017 dhe 50 procedime të filluara gjatë vitit 2018, gjithsej 73 procedime penale. Nga keto procedime 50 procedime janë përfunduar me relacionin përkatës duke sugjeruar edhe mënyrën e përfundimit të çështjes, ndërsa 23 procedime janë mbartur në vitin 2019.

Nga oficeri Ludovik Ndokaj janë marre 3 procedime të filluara gjatë vitit 2017. dhe 9 procedime të filluara gjatë vitit 2018, gjithsej 12 procedime penale Nga

-16-

keto procedime 12 janë përfunduar me relacionin përkatës duke sugjeruar edhe mënyrën e përfundimit të çështjes.

Për sa i përket ngarkesës së punës Prokurorëve dhe Oficerëve të Policisë Gjyqësore si dhe Oficerëve të Sherbimeve të Policisë Gjyqësore procedimet penale janë ndare në mënyrë të drejtë duke patur parasysh

veshtiresine dhe volumin e punes se tyre, kompleksitetin e tyre dhe rëndësine e veprave penale te hetuara nga sejcili Prokuror apo oficer i policise gjyqesore.

Gjatë periudhes 1-vjeçare nga Prokurori i Rrethit Gjyqesor Pukë, nuk ka pasur raste te shfuqizimit te vendimeve te Prokuroreve .

Përsa i perket stafit, ne pergjithesi është kerkuar nje zbatim me korrektesi i disjplines ne pune dhe etikes se tyre gjate ushtrimit te detyres. Vihet ne dukje se stafi administrates i kesaj prokurorie është relativisht i vogel, çka ka ndikuar dhe veshtiresuar perfundimin e akteve dhe ushtrimin e detyrave te ndryshme procedurale dhe administrative ne nje kohe sa me te shpejtë.

Gjithashtu, ne lidhje me urdherat dhe udhezimet e Prokurorit te Pergjithshem te ardhura ne Prokurori, jane njohur te gjithë punonjesit, konkretisht Prokuroret dhe Oficeret e Policise Gjyqesore dhe administrata.

Për sa i perket pageses se gadishmerise dhe te oreve te kryera mbi kohen normale, per Prokuroret, Oficeret e Policise Gjyqesore keto jane perlllogaritur sipas nje grafiku mujor te sherbimit te gadishmerise, miratuar nga drejtuesi i prokurorise.

Për sa i perket marredhenieve me Drejtues te Institucioneve te tjera si:

- Me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, marredheniet kane qene të mira, korrekte dhe institucionale, është kërkuar rritja e bashkepunimit ne drejtim te permiresimit ne lidhje me shpejtesine e gjykimit te procedimeve penale, administrimit te vendimeve te masave te sigurise dhe atyre te formes prere ne lidhje me ekzekutimin e tyre, etj.
- Me Drejtorinë e Policise së Qarkut Shkodër dhe Komisariatit e Policise Pukë, marredheniet kane qene shume te mira, te kenaqshme, rezulton se ka pasur rritje te bashkepunimit mes dy intitucioneve ne drejtim te rritjes se cilesise dhe shpejtesise se hetimit te kallezimeve dhe procedimeve

-17-

- penale. Problem shqetesues vazhdon te jete mungesa e oficereve te seksioneve, levizja e tyre e shpështë, tranferimi, zevendesimi i tyre, mungesa e pervojes ne fusha te ndryshme te hetimit dhe veprat e reja, qe kane ndikuar ne cilesine e hetimit, shpejtesine dhe ne pezullimin dhe pushimin e nje numri te konsiderueshem te procedimeve penale.

- Me zyren e Permbarrimit Pukë, marrëdhëniet kanë qenë shumë të mira, është bashkëpunuar në vazhdimësi në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të denimit me gjobe dhe shpenzimeve gjyqesore.
- Me Zyren e Sherbimit të Proves Pukë, marrëdhëniet me këtë institucion kanë qenë shumë të mira, është rritur bashkëpunimi dhe efikasiteti si rrjedhojë e afersisë së saj me vendbanimin e të denuarve. Gjithashtu, ka një përmirsim në lidhje me njoftimin dhe paraqitjen e të denuarve me kusht dhe ekzekutimin e këtyre denimeve alternative.
- Me institucionet e pushtetit lokal, si N/prefekturën, Bashkitë, Njësia Administrative dhe drejtoritë lokale, dhe institucionet e tjera, marrëdhëniet kanë qenë korrekte, të mira, por vlerësojmë se ka vend për më shumë bashkëpunim dhe efikasitet.

Problematikat e punës në vitin 2018, ka konsistuar kryesisht, por jo vetëm;

1. Numrin e paket dhe levizjet e shpërndara dhe problematike të oficerëve të policisë gjyqesore të Komisarariatit Pukë dhe Drejtorisë së Policisë Shkoder, që ka shkaktuar vonës në hetim, zgjatjen e tyre si pasoje të zëvendësimit të oficerëve, si dhe transferimi i menjehershëm të oficerëve pa njoftuar Prokurorinë, kur oficeri ka pasur në hetim një numër të konsiderueshëm të procedimeve, procedime komplekse apo edhe në përfundim të afatëve .
2. Niveli dhe profesionalizmi i një pjese të oficerëve të policisë gjyqesore nuk është i kënaqshëm, ku rezulton se oficerët nuk kanë aftësi dhe eksperiencën e duhur në fushën e ndryshme të hetimit, fakt ky që ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësinë e hetimeve.
3. Ardhja me shumë vonës të akteve të ekspertëve të ndryshëm, sidomos nga D.P.SH Tirane, riekspertimet, ardhja me vonës të tabelave fotografike të kqyerjeve, vonës në përgjigjet të tabulateve të kompanive telefonike, kanë ndikuar drejtpërdrejtë në cilësinë dhe kohëzgjatjen e hetimeve.

-18-

4. Mungesa e psikologëve dhe të ekspertëve të ndryshëm dhe përkthyesve në rrethin e Pukës, për kryerjen e ekspertëve të ndryshëm ligjorë, përkthimeve, etj dhe vonës në gjetjen dhe kryerjen e ekspertëve nga ekspertët jashtë rrethit, kanë ndikuar në afatet e hetimit, etj...

Ne vitin 2018 per Prokurorine Puke na jane vene ne dispozicion fondet si me poshte :

Ne zerin 600, ku perfshihen pagat e punonjesve kemi patur ne dispozicion 8.307.000 leke, nga kjo shume i jane kaluar ne dispozicion te Prokurorise se

Pergjithshme Tirane 1.300.000 leke, kjo per faktin se ne periudhat kohore te ndryshme gjate vitit 2018 kemi patur mungesa ne organik, ndersa me shuma prej 8.165.946 leke jane bere pagesat e punonjesve .

Ne zerin 601, qe perfaqeson pagesat per sigurimet shoqerore dhe shendetesore te punonjesve te kesaj Prokurorie, kemi patur ne dispozicion 1.127.000 leke, nga shuma jane transferuar ne Prokurorine e Pergjithshme shume prej 200.000 leke, ndersa jane shpenzuar ne shumen 1.096.918 leke.

Ne zerin 602, qe perfaqeson te gjitha shpenzimet operative te institucionit, si dhe pagesat e eksperteve dhe te avokateve per vitin 2018, kemi patur ne dispozicion shumen prej 2.420.000 leke. Pagesat per sherbimet e ndryshme jane bere sipas rregullave ne kohen e duhur, nga ku ka rezultuar se nuk kemi mbart ne vitin 2019 asnje fature financiare, apo shpenzime per pagesat e eksperteve dhe te avokateve te pa paguara nga viti 2018, duke perjashtuar vetem fatura e sherbimit per muajin Dhjetor 2018 ku pasi na jene vene ne dispozicion ne muajin Janar 2019 është bere edhe likujdimi i tyre.

Problem shqetesues kemi lidhur me gjendjen e arkives qe ndodhet tek godina e Prokurorise se rrethit Gjyqesor Puke , ku per munges ambjenti jemi vene ne veshtiresi per arshivimin e dosjeve dhe te provave materiale, pasi nuk kemi ambjent tjetër, ku per kete arsye kemi bere kerkese çdo vite per shtes objekti, gje e cila ne vleresimin tone është e domosdoshme .

Per sa i perket vitit 2019, prioritetet kryesore te punes sone do te perqendrohen ne perfundimin sa me shpejt te procedimeve te mbartura nga viti i kaluar brenda afatit te hetimeve.

-19-

Një kujdes me i madh duhet kushtuar ne mbikqyerjen e ekzekutimit te vendimeve penale si ato me burgim dhe gjobe.

Prioritet i punes tone perveç te tjerave gjate vitit 2019, do te jete:

1. Implementimi me sukses i gjithe ndryshimeve ne K.Penal dhe K.Pr.Penale duke duke i dhene perparesi pavaresise se prokuroreve ne vendimarrje por edhe aplikimit te instituteve te reja te parashikuara ne keto Kode.
2. Rritja e funksionit drejtues dhe kontrollues të prokurorit në hetimet paraprake të kryera nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore.
3. Rritja e cilesise se hetimit, duke ulur ne maksimum rastet e pafajesive dhe pushimit te çështjeve, e veçanerisht ato me te arrestuar;
4. Përfundimin e hetimeve brenda afatit 3 mujor;
5. Uljen e numrit te procedimeve te pezulluara;
6. Rritjen e numrit te procedimeve penale te ekzekutuara;
7. Përmirësimi i organizimit, drejtimit dhe kontrollit brenda organit të Prokurorisë ne perputhje me Ligjin nr.97/2016 “Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë ne Republiken e Shqipërisë”, si dhe “Rregullores Standarte te Organizimit dhe Funksionimit te Prokurorisë te Juridiksionit te Pergjithshem” për tu pershtatur me ndryshimet e ketij ligji me synimin per t’ju përgjigjur në kohë dhe me cilësi kërkesave të luftës kundër kriminalitetit, forcimit te dielines se brendshme dhe te vullnetit per te identifikuar cdo lloj problematike brenda organit dhe per ta goditur ate perpara se te ndodhe.
8. Respektimi i detyrimeve të ligjit procedural penal, rekomandimeve te Keshillit te Ministrave per luften kundër kriminalitet dhe Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm ne kete drejtim.

Duke ju falenderuar te gjithe te pranishmit, për pjesemarrjen dhe mirekuptimin, në paraqitjen e analizes së Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë, për vitin 2018. Urojmë të arrijmë nje nivel më të lartë dhe suksese të përbashketa, per vitin 2019.

Pukë, me 27.02.2019.

DREJTUESI I PROKURORISË

ELIDJANA KASA